



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

C.nr.134/09

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, departamenti i përgjithshëm (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimorë e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, në çështjen juridike të paditëses: PTK me seli në Prishtinë të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson _____ kundër të paditurit: I _____ nga fshati _____, baza e kontestit: Borxh, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 25.03.2013 me datën 02.04.2013 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- **OBLIGOHET i padituri** ! _____ nga fshati _____ Komuna e Mitrovicës që t'i paguajë paditëses në emër të borxhit për shërbimet e shfrytëzuara të paditëses shumë prej 72 euro me kamatë që aplikohet sipas lartësisë në mjetet afariste në baza vjetore në bankat afariste pa destinim të caktuar
- **OBLIGOHET** i padituri që në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguajë paditëses shumë prej 15 euro, ndërsa gjykatës në emër të shpenzimeve për përpilimin e aktgjykimit të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm

A r s y e t i m

Paditësja me anë të padisë por edhe në seancë kryesore kërkoi nga gjykata që ta detyron të paditurin që në emër të borxhit t'ia paguajë paditëses shumë prej 72 euro, pasi në seancë kryesore bëri precizimin e kërkespadiisë (zvoglimin e saj).

Seanca përgatitore dhe ajo kryesore u mbajt në mungesë të palës së paditur pasi i njëjti edhe pse i ka pranuar ftesat me rregull mungesën nuk e ka arsyetuar.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike gjykata në seancën kryesore administroi këto prova: kontratën për pagimin e borxhit e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurit e dt.26.09.2008, pasqyra e borxhit e dt. 08.09.2009, kopja e letërnjoftimit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditëses deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkespadiës duke bërë njëkohësisht zvoglimin e kërkespadiës, pasi që në ndërkohë i padituri pjesën tjetër të borxhit e kishte paguar pasi që paditësja kishte ushtruar në gjykatë padinë.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi në pajtim me nenin: 7 dhe 8 të LPK-së dhe erdhi në këto përfundime:

Nuk është kontestuese se i padituri i ka borxh paditëses pasi që nga kontrata mbi pagimin e borxhit me këste vërtetohet se i padituri ka pranuar me nënshkrimin e kësaj kontrate se i ka borxh paditësit, mirëpo sa i përket shumës së borxhit, meqenëse i padituri në ndërkohë një pjesë të borxhit.

Gjykata lidhur me pikën e parë të dispozitivit vendosi në bazë të nenit 124 në lidhje me nenin 394 të LMD-së të vitit 1978, ndërsa lidhur me lartësinë lidhur me aplikimin e lartësisë së kamatës, gjykata u bazua në nenin 277, par 1 të LMD-së.

Sa i përket vendosjes mbi shpenzimet procedurale, sipas pikës 2 të dispozitivit u bazua në nenin 452 par 1 të LPK-së , ndërsa lidhur me vendosjen mbi shpenzimet gjyqësore u bazua në nenin 10.12 në lidhje me nenin 10.1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore nr.2008.

Gjykata aktgjykimin e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,
C.nr.134/2009 me dt. 02.04.2013

GJYQTARI,
Faton Ademi



UDHËZIM PËR MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.